- Punimi me dorë i filetës së jashtme.
- Rregullat e sigurimit teknike të ruajtjes së mjedisit gjatë filetitimit me dore.

RM 7 Nxënësi kryen punime zmerilimi dhe pastrimi, me retifikuesë dore.

Përmbajtja:

- Përgatitja e pjesëve për zmerilim.
- Zmerilimi i ashpër i tegelave të salduar.
- Zmerilimi finok (lustrimi i tegelave të salduar).
- Pastrimi i buzëve të pjesëve përgatitëse për saldim.
- Pastrimi i buzëve të pjesëve përgatitëse për axhustim.
- Respektimi i rregullave të sigurisë dhe ruajtja e mjedisit gjatë punimeve me zmerilim.

Procedurat e vlerësimit

Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjithë kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Më poshtë jepen shkurtimet që do të përdoren:

RM Rezultatet e të mësuarit

IV Instrumentet e vlerësimit

KR Kriteret e realizimit

RM 1 IV Vëzhgim i demonstrimit të nxënësit me listë-kontrolli:

KR Nxënësi duhet të:

- përzgjedhë drejt e instrumentet matëse e kontrolluese;
- kryejë matje të sakta me metër;
- kryejë matje të sakta me nonius;
- kryejë matje të sakta me mikrometër;
- kryejë matje të sakta me komparator;
- kryejë matje të sakta me këndmatës;
- kryejë matje të sakta me manometër;
- bëjë shënimet e nevojshme me instrumente shënuese të llojeve të ndryshme.

RM 2 IV Vëzhgim i demonstrimit të nxënësit me listë-kontrolli:

KR Nxënësi duhet të:

- interpretojë drejt skicën ose vizatimin e detalit;
- përzgjedhë drejt gjysëmfabrikatin;
- përzgjedhë drejt veglat e punës;
- përzgjedhë drejt limat për limim;
- përzgjedhë drejt instrumentet matëse-kontrolluese;
- vendosë dhe shtrëngojë siç duhet copën në mengene;

- përcaktojë drejt regjimin e limimit;
- kryejë limime të sipërfaqeve të rrafshta;
- kryejë limime të sipërfaqeve nën kënd;
- kryejë limime të sipërfaqeve të rrumbullakta;
- heqë siç duhet copën;
- zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit gjatë limimit;
- mirëmbajë menginat, veglat dhe limat.

RM 3 IV Vëzhgim i demonstrimit të nxënësit me listë-kontrolli:

KR Nxënësi duhet të:

- interpretojë drejt skicën ose vizatimin e detalit;
- përzgjedhë drejt gjysëmfabrikatin;
- përzgjedhë drejt veglat e punës;
- vendosë dhe shtrëngoje siç duhet copën në mengene;
- kryejë sharitje me sharrë dore;
- kryejë prerje me gërshërë;
- kryejë prerje me daltë;
- kryejë prerje me fleks;
- heqë siç duhet copën nga mengena;
- zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit gjatë sharritjes;
- mirëmbajë veglat dhe pajisjet e punës.

RM 4 IV Vëzhgim i demonstrimit të nxënësit me listë-kontrolli:

KR Nxënësi duhet të:

- interpretojë drejt skicën ose vizatimin e detalit;
- përzgjedhë drejt gjysëmfabrikatin;
- përzgjedhë drejt veglat e punës;
- vendosë dhe shtrëngoje siç duhet copën;
- kryejë lakimin e copës me vegël doracake;
- kryejë lakimin e copës me pajisje lakimi universale;
- kryejë formësimin e copës me vegla doracake;
- heqë siç duhet copën;
- zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit gjatë lakimit dhe formësimit;
- mirëmbajë veglat dhe pajisjet për lakim dhe formësim.

RM 5 IV Vëzhgim i demonstrimit të nxënësit me listë-kontrolli:

KR Nxënësi duhet të:

- interpretojë drejt skicën ose vizatimin e detalit;
- përzgjedhë drejt gjysëmfabrikatin;
- përzgjedhë drejt veglat e punës;
- vendosë dhe shtrëngoje siç duhet copën në mengene;
- kryejë shpimin e vrimës në përmasat e kerkuara;
- kryejë zgjerimin e vrimës në përmasat e kerkuara;
- kryejë alezimin e vrimës në përmasat e kerkuara;

- heq siç duhet copën, instrumentin dhe pajisjet ndihmëse;
- zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit gjatë shpimit, zgjerimit dhe alezimit;
- mirëmbajë veglat dhe pajisjet e punës.

RM 6 IV Vëzhgim i demonstrimit të nxënësit me listë-kontrolli:

KR Nxënësi duhet të:

- interpretojë drejt skicën ose vizatimin e detalit;
- përzgjedhë drejt gjysëmfabrikatin;
- përzgjedhë drejt veglat e punës;
- përcaktojë saktë diametrin e shufrës për filetim (bazuar në standarde);
- përzgjedhë madravidat e duhura dhe mbajtësit përkatës;
- përcaktojë saktë diametrin e vrimës për filetim të brendshëm;
- përzgjedhë drejt meshkujt për filetim të brendshëm;
- vendosë dhe shtrëngoje siç duhet copën në mengene;
- kryejë punime me dorë të filetitimit të brendshëm;
- kryejë punime me dorë të filetos së jashtme;
- heqë siç duhet copën nga mengena;
- zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit gjatë filetitimit me dorë;
- mirëmbajë veglat dhe pajisjet e punës.

RM 7 IV Vëzhgim i demonstrimit të nxënësit me listë-kontrolli:

KR Nxënësi duhet të:

- interpretojë drejt skicën ose vizatimin e detalit;
- përzgjedhë drejt veglat e punës;
- vlerësojë cilësinë e zmerilimit;
- vendosë dhe shtrëngoje siç duhet copën;
- kryejë zmerilimet e duhura;
- zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit gjatë zmerilimit;
- mirëmbajë veglat dhe pajisjet e punës.

Metodat e të mësuarit të rekomanduara

- Trajtimi i këtij moduli duhet të bëhet kryesisht në repartin e axhusterisë.
- Gjatë trajtimit të modulit, mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë që të jetë e mundur demonstrime konkrete të proceseve të limimit, sharritjes me dorë, prerjes, zmerilimit, shpimit, lakimit dhe formësimit, hapjes së fileteve.
- Nxënësit duhet të praktikohen sa më shumë të jetë e mundur për kryerjen e veprimeve përgatitore dhe të punës, punime limimi, prerje me gërshërë, prerje me sharrë dhe daltë, punime shpimi, hapje të filetos, punime të zmerilimit, lakimit dhe formësimit.

-
- Nxënësit duhet të angazhohen në vëzhgime dhe diskutime në lidhje me çështjet e ndryshme të punimeve axhusterike-limim, sharritje, prerje me gërshërë, zmerilim, lakim, formësim, hapje të filetave etj.
 - Mësuesi i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të mbrojtjes në punë, ruajtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së makinës dhe pajisjeve.
 - Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të synohet në demonstrimin praktik të njohurive dhe aftësive të fituara.

**Baza materiale
e domosdoshme**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, makinat, veglat, pajisjet, instrumentet dhe materialet e mëposhtme:

- Repart axhusterie.
 - Vegla pune, instrumente matëse dhe prerëse për limim, sharritje me dorë, prerje, lakim dhe formësim, shpim, filetim me dorë, zmerilim.
 - Gjysëmfabrikate të ndryshme për punime axhusterie.
 - Pankarta, makete, udhëzuesa, katalogë, rregullore, standarde, etj.
 - Vizatime dhe skica të detaleve tipike dhe pjesëve që do të punohen me metoda axhusterie.
-

PËRSHKRUESI I MODULIT TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

“Mirëmbajtja e vijave hekurudhore”

Lëmia:	Transport
Profili:	Lëvizja e trenave, Tërheqja a trenave
Niveli:	I
Klasa:	10

Numri i modulit 2

Qëllimi i modulit Një modul që aftëson nxënësit për të kryer punime, të tilla si shpuarja e traversave dhe shtëngimi i bulonave, zëvendësimi i pjesëve të dëmtuara, lubrifikimi i shinave që ndihmojnë për mirëmbajtjen e vijave hekurudhore.

Kohëzgjatja e modulit 6 kredite (36 orë)

Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe përmbajtja	RM 1 Nxënësi kryen veprimet përgatitore për mirëmbajtjen e vijave hekurudhore. Përmbajtja: <ul style="list-style-type: none">- Marrja dhe leximi i urdhërit përkatës.- Përzgjedhja dhe ngarkimi i veglave, mjeteve dhe materialeve të punës.- Njoftimi i stacionit për gatishmërinë për punë.
	RM 2 Nxënësi kryen veprimet për evitim të mangësive në vijën hekurudhore (binarët). Përmbajtja: <ul style="list-style-type: none">- Identifikimi i vendit të intervenimit.- Çlirimi i bulonave dhe trifonave- Heqja e shinës.- Heqja e pragut.- Zëvendësimi i pragut të dëmtuar.- Zëvendësimi i shinës së dëmtuar.- Shpuarja e traversave.- Lidhja e shinës me pragun.- Shtëngimi i bulonave dhe trifonave- Lubrifikimi i shinave.- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të mirëmbajtjes së vijës hekurudhore.

Procedurat e vlerësimit	Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjithë kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit. Më poshtë jepen shkurtimet që do të përdoren: RM Rezultatet e të mësuarit IV Instrumentet e vlerësimit
--------------------------------	---

KR	Kriteret e realizimit
-----------	------------------------------

RM 1 IV Vëzhgim i demonstrimit të nxënësit me listë-kontrolli:

KR Nxënësi duhet të:

- marrë dhe lexojë me kujdes urdhërin me shkrim nga përgjegjësi (nga kryepunëtori), për vendin dhe kohën e intervenimit;
- përzgjedhë dhe ngarkojë në drezinë veglat, mjetet dhe materialet e punës;
- njoftojë stacionin për gatishmërinë për punë;
- zbatojë rregulloren e mirëmbajtjes së vijës hekurudhore.

RM 2 IV Vëzhgim i demonstrimit të nxënësit me listë-kontrolli:

KR Nxënësi duhet të:

- identifikojë vendin e intervenimit;
- çlirojë bulonat dhe trifonat;
- heqë shinën me mjetin përkatës;
- heqë pragun me mjetin përkatës;
- zëvendësojë pragun (traverzën) e dëmtuar;
- zëvendësojë shinën e dëmtuar;
- shpojë traverzën me burgi;
- lidhë shinën me pragun (traverzën) duke respektuar përmasat standarde të binarëve;
- shtërngojë bulonat dhe tironat
- lubrifikojë shinat, kur është e nevojshme;
- përdorë siç duhet mjetet, pajisjet dhe veglat e punës;
- zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të mirëmbajtjes së vijës hekurudhore;
- zbatojë rregulloren e mirëmbajtjes së vijës hekurudhore lidhur me standardet e binarëve.
- mirëmbajë veglat dhe mjetet e punës.

Metodat e të mësuarit të rekomanduara

- Trajtimi i këtij moduli duhet të bëhet kryesisht në stacionet hekurudhore, vijën e hapur hekurudhore ose në mjedise të improvizuara të vijës hekurudhore.
- Gjatë trajtimit të modulit, mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë që të jetë e mundur demonstrime konkrete të proceseve të mirëmbajtjes së vijës hekurudhore, si matja e përmasave të binarëve, krahasimi me standardin (toelrancat), zëvendësimin e pjesëve të dëmtuara, lubrifikimin e shinave etj.
- Nxënësit duhet të praktikohen sa më shumë të jetë e mundur për kryerjen e veprimeve përgatitore dhe të punës, leximin me kujdes të urdhërit për intervenim, përzgjedhjen e duhur të veglave, pajisjeve dhe mjeteve të punës, kryerjen e matjeve të nevojshme, kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes së vijës

hekurudhore etj.

- Nxënësit duhet të angazhohen në vëzhgime dhe diskutime në lidhje me çështjet e ndryshme të punimeve si interpretimin e urdhërit për intervenim dhe përcaktimin e vendit të intervenimit, përzgjedhjen e duhur të veglave, pajisjeve dhe mjeteve të punës, kryerjen e matjeve të nevojshme, kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes së vijës hekurudhore etj.etj.
- Mësuesi i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të mbrojtjes në punë, ruajtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së veglave dhe pajisjeve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të synohet në demonstrimin praktik të njohurive dhe aftësive të fituara.

**Baza materiale
e domosdoshme**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, makinat, veglat, pajisjet, instrumentet dhe materialet e mëposhtme:

- Drezinë.
 - Vegla pune dhe instrumente matëse për zëvendësimin e pjesëve të dëmtuara të vijës hekurudhore, të tilla si pajisje matëse, pajime për mbajtjen e shinave, leva, çelsa për lirim-shtrëngim bullonash.
 - Prexha, shina, elemente lidhëse të shinave, lubrifikante.
 - Pankarta, makete, udhëzuesa, katallogë, rregullore, standarde, etj.
 - Skica të pjesëve që do të punohen.
-

PËRSHKRUESI I MODULIT TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

“Udhëzimi i udhëtarëve”

Lëmia:	Transport
Profili:	Lëvizja e trenave
Niveli:	I
Klasa:	10

Numri i modulit 3

Qëllimi i modulit Një modul praktik që aftëson nxënësin me aftësi praktike për të kryer veprimet për të udhëzuar udhëtarët, që të orientohen në shërbimet të cilat i ofron hekurudha për transport.

Kohëzgjatja e modulit 4 kredite (24 orë)

Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe përmbajtja	<p>RM 1 Nxënësi orienton udhëtarët për shërbimet të cilat u nevojiten.</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">- Analiza e detyrave të marrura nga mbikqyrësi.- Përzgjedhja e vendit më të përshtatshëm për vëzhgimin e udhëtarëve.- Indetifikimi i udhëtarëve të cilët kanë nevojë për ndihmë – njoftime.- Njoftimi i udhëtarëve për sportelet e dedikuar për dhënie e biletave.- Njoftimi i udhëtarëve për peronat ku janë të vendosur trenat.- Njoftimi i udhëtarëve me orarin e lëvizjeve të trenave. <p>RM 2 Nxënësi kryen shërbime të thjeshta për të udhëzuar udhëtarët dhe ruajtjen e ambientit.</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">- Përzgjedhja e vendit më të përshtatshëm për vëzhgimin e udhëtarëve.- Përzgjedhja e orarit të trenave.- Udhëzimi i udhëtarëve për trenat sipas kërkesave nga udhëtarët.- Ndihma për kalimin e binarëve dhe përzgjedhjen e trenit të duhur.- Ndihma për personat me aftësi të kufizuara.- Rregullat për mbajtjen pastër të mjedisit.- Rregullat e mirësjelljes.
---	---

Procedurat e vlerësimit	Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjithë kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit. Më poshtë jepen shkurtimet që do të përdoren: RM Rezultatet e të mësuarit
--------------------------------	--

IV	Instrumentet e vlerësimit
KR	Kriteret e realizimit

- RM 1 IV** Vëzhgim i demonstrimit të nxënësit me listë-kontrolli:
- KR** Nxënësi duhet të:
- analizojë urdhërin e detyrave, të dhënë nga mbikqyrësi;
 - përzgjedhë drejt vendin e pozicionimit për vëzhgimin e udhëtarëve;
 - identifikojë udhëtarët të cilët kanë nevojë për udhëzime dhe ndihmë;
 - ofrojë ndihmën e kërkuar duke dhënë udhëzime të sakta;
 - komunikojë qartë dhe rrjedhshëm me udhëtarët;
 - njoftojë udhëtarët për sportelet e dedikuara për dhënien e biletave;
 - njoftojë udhëtarët për peronat përkatës;
 - kujdeset për përzgjedhjen e trenave përkatës;
 - zbatojë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit.

- RM 2 IV** Vëzhgim i demonstrimit të nxënësit me listë-kontrolli:
- KR** Nxënësi duhet të:
- përzgjedhë drejt vendin e pozicionimit për vëzhgim
 - identifikojë udhëtarët të cilët kanë nevojë për udhëzime dhe ndihmë;
 - ofrojë ndihmën e kërkuar;
 - komunikojë qartë dhe rrjedhshëm me udhëtarët;
 - përzgjedhë drejt orarin e lëvizjes së trenave për të mundësuar ndihmën ndaj udhëtarëve;
 - kujdeset për përzgjedhjen e trenave përkatës nga ana e udhëtarëve;
 - shoqërojë udhëtarët për kalimin e tyre në peronat përkatës;
 - japë ndihmën e duhur për personat me aftësi të kufizuara;
 - kërkojë nga udhëtarët mbajtjen pastër të mjedisit;
 - zbatojë rregullat e etikës qytetare dhe profesionale;
 - zbatojë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Metodat e të mësuarit të rekomanduara

- Trajtimi i këtij moduli duhet të bëhet kryesisht në stacionet hekurudhore ose në mjedise të improvizuara.
- Gjatë trajtimit të modulit, mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë që të jetë e mundur demonstrime konkrete të dhënies së udhëzimeve dhe ndihmës për udhëtarët duke organizuar edhe lojë me role (një nxënës udhëtar dhe tjetri që jep udhëzimet dhe ndihmën e duhur).
- Nxënësit duhet të praktikohen sa më shumë të jetë e mundur për kryrjen e veprimeve konkrete për dhënien e udhëzimeve

dhe ndihmës për udhëtarët.

- Nxënësit duhet të angazhohen në vëzhgime dhe diskutime në lidhje me rastet e ndryshme që mund të paraqiten gjatë punës.
- Mësuesi i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të synohet në demonstrimin praktik të aftësive të fituara.

**Baza materiale
e domosdoshme**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, dhe materialet e mëposhtme:

- Stacioni hekurudhor ose mjedis i improvizuar i tij.
 - Orar i lëvizjes së trenave.
 - Pankarta, makete, udhëzues, rregullore etj.
-

Klasa 11

Programet e lëndëve profesionale

Programi i lëndës

“Organizimi i komunikacionit hekurudhor”

<u>Lëmia:</u>	Transport
<u>Profili:</u>	Lëvizja e trenave
<u>Niveli:</u>	I
<u>Klasa:</u>	11

Qëllimet e lëndës

Në përfundim të trajtimit të lëndës në klasën e 11-të, nxënësi duhet të:

- shpjegojë rëndësinë e komunikacionit si pjesë e procesit të prodhimit;
- shpjegojë vendet zyrtare në komunikacionin hekurudhor;
- shpjegojë njësitë punuese dhe personelin ekzekutiv në të;
- shpjegojë pajisjet dhe stabilimentet hekurudhore për kryerjen e komunikacionit hekurudhor;
- shpjegojë llojet e trenave dhe rregullat e përgjithshme të emërtimit;
- shpjegojë, lexojë dhe interpretojë sinjalizimin hekurudhor;
- lexojë dhe regjistrojë shënimet nga vagonët hekurudhorë;
- shpjegojë dhe interpretoj manovrimin
- përshkruajë përgatitjen, formimin dhe shformimin e trenave;
- shpjegojë dokumentet teknike të stacionit

Fondi i orëve të lëndës

35 javë x 3 orë/javë = 105 orë

Programi i hollësishëm i lëndës

Kapitulli 1: Hyrje

3 orë

e) Qëllimet e kapitullit

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet të:

- përshkruajë shkurt historikun e zhvillimit të hekurudhave në botë dhe në Kosovë;
- shpjegojë rolin dhe vendin e komunikacionit në zhvillimin e shoqërisë;
- rendisë llojet e dhe vartësinë e degëve të komunikacionit;
- shpjegojë rolin e komunikacionit hekurudhor.

f) Temat e kapitullit

- Historik i shkurt i zhvillimit të hekurudhës në Botë dhe në vend.
- Rëndësia e komunikacionit në zhvillimin e shoqërisë.
- Llojet e komunikacionit dhe lidhshmëria e bashkëveprimi i tyre.
- Roli i komunikacionit hekurudhor.

g) Udhëzime didaktike për kapitullin

Rekomandohet që mësuesi të:

- bëjë ilustrim me foto, maket;
- bashkëbisedojë me nxënësit;
- organizojë ligjërata nga një përfaqësues i sistemit hekurudhor.

h) Kushtet për realizimin e kapitullit

- hartë me rrjet të hekurudhave;
- foto (nëse disponon)

Kapitulli 2: Vendet zyrtare në shërbimit të komunikacionit

4 orë

a) Qëllimet e kapitullit

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet të:

- përshkruajë llojet e vendeve zyrtare;
- shpjegojë veçoritë e vendeve zyrtare;
- skicojë vende zyrtare.

b) Temat e kapitullit

- Stacionet hekurudhore
- Llojet e stacioneve hekurudhore.
- Skicimi i stacioneve hekurudhore sipas llojeve.
- Vendet tjera zyrtare në hekurudhë.

c) Udhëzime didaktike për kapitullin

Rekomandohet që mësuesi të:

- bëjë ilustrim me foto, makete;
- bashkëbisedojë me nxënësit.

d) Kushtet për realizimin e kapitullit

- makete dhe foto (nëse disponon).
- Skica të stacioneve.

Kapitulli 3: Njësitë punuese dhe personeli

2 orë

a) Qëllimet e kapitullit

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet të:

- shpjegojë rolin dhe detyrat e njësive punuese;
- argumentojë përse personeli i cili është i kyçur në ekzekutimin e komunikacionit duhet të plotësojë kritere të veçanta.

e) Temat e kapitullit

- Njësit e komunikacionit dhe teknike për realizimin e shërbimit të komunikacionit.
- Personeli ekzekutiv në këto njësi.

f) Udhëzime didaktike për kapitullin

Rekomandohet që mësuesi të:

- trajtojë shembuj konkretë të njësive;
- skicojë onogramin e personelit;

- bashkëbisedojë me nxënësit;
- organizojë punë në grupe.

g) Kushtet për realizimin e kapitullit

- Skica;
- Onogramin e sistematizimit.

Kapitulli 4: Stabilimentet për rregullimin e komunikacionit

8 orë

a) Qëllimet e kapitullit

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet të:

- shpjegojë linjat hekurudhore;
- skicojë pamjet e linjave një binarshe nga ato dy binarshe;
- shpjegojë pajisjet sinjalo-siguruese;
- shpjegojë ndërrueset;
- skicojë ndërrueset varësisht nga llojet;
- shpjegojë pozitat e ndërrueseve;
- shpjegojë mënyrën e sigurimit;

h) Temat e kapitullit

- Linjat hekurudhore dhe pajisjet hekurudhore.
- Pajisjet sinjalo- siguruese në linja hekurudhore dhe në stacione.
- Ndërrueset.

i) Udhëzime didaktike për kapitullin

Rekomandohet që mësuesi të:

- trajtojë shembuj konkret të linjave dhe pajisjeve sinjalo- siguruese;
- trajtojë shembuj konkret të tipave të ndërrueseve;
- bëjë ilustrim me foto, makete, skica;
- bashkëbisedojë me nxënësit;
- organizojë ekskursion mësimor.

j) Kushtet për realizimin e kapitullit

- Skicat përkatëse.

Kapitulli 5: Trenat

6 orë

a) Qëllimet e kapitullit

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet të:

- përshkruajë llojet e trenave dhe veçoritë dalluese të tyre;
- shpjegojë emërimin e trenave;
- shpjegojë rregullat e përgjithshme të emërtimit

k) Temat e kapitullit

- Nocioni, lloji i trenave dhe rangu.
- Ndarja e trenave sipas llojit të transportit.
- Rregullat e përgjithshme të emërtimit.

l) Udhëzime didaktike për kapitullin

Rekomandohet që mësuesi të:

- ilustrojë çështjet që trajton me shembuj konkretë;
- bëjë ilustrim me foto, makete;
- bashkëbisedojë me nxënësit;

m) Kushtet për realizimin e kapitullit

- Foto, maketa

Kapitulli 6: Sinjalizimi hekurudhor

32 orë

a) Qëllimet e kapitullit

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet të:

- shpjegojë nocionet bazë të sinjalizimit;
- bëjë ndarjen e shenjave sinjalizuese;
- shpjegojë dhe interpretojë shenjat sinjalizuese në ndërruese;
- shpjegojë shenjat sinjalizuese manovruese;
- shpjegojë dhe interpretojë shenjat sinjalizuese të personelit manovrues;
- shpjegojë shenjat sinjalizuese në trena;
- shpjegojë sinjalet kryesore;
- shpjegojë shenjat sinjalizuese në sinjale kryesore;
- shpjegojë para sinjalet e sinjaleve kryesore;
- shpjegojë shenjat sinjalizuese të para sinjaleve.

n) Temat e kapitullit

- Nocioni bazë i sinjalizimit.
- Ndarja e shenjave sinjalizuese.
- Shenjat sinjalizuese në ndërruese.
- Sinjalet manovruese.
- Shenjat sinjalizuese manovruese.
- Shenjat sinjalizuese në trena.
- Sinjalet kryesore.
- Llojet e sinjaleve kryesore dhe vendvendosja e tyre.
- Shenjat sinjalizuese e sinjaleve kryesore.
- Para sinjalet e sinjaleve kryesore.
- Shenjat sinjalizuese të para sinjaleve.
- Shenjat sinjalizuese për provë- verifikim të frenimit.
- Shenjat sinjalizuese të personelit në linjë hekurudhore

o) Udhëzime didaktike për kapitullin

Rekomandohet që mësuesi të:

- bëjë ilustrim me foto, maket dhe me gjestet përkatëse;
- bashkëbisedojë me nxënësit;
- organizojë ekskursione mësimore.

p) Kushtet për realizimin e kapitullit

- Foto- skica
- Pasqyra e shenjave sinjalizues

Kapitulli 7: Manovrimi

32 orë

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet të:

- shpjegojë nocionet bazë të manovrimit;
- shpjegojë dhe interpretoj ruajtjen e sigurisë gjatë manovrimit;
- përshkruajë stabilimentet për manovrim;
- shpjegojë dhe interpretoj personelin manovrues;
- shpjegojë mënyrën e komunikimit gjatë manovrimit;
- shpjegojë dhe interpretoj mënyrën vëzhgimit rrugëtimit gjatë manovrimit;
- shpjegojë dhe interpretoj përdorimin e mjeteve të punës në varësi të rastit që paraqitet;
- shpjegojë mënyrën e kyçjes së vagonëve gjatë manovrimit;
- shpjegojë mënyrën ndarjes së vagonë gjatë manovrimit;
- shpjegojë dhe interpretoj llojet e lëvizjeve gjatë manovrimit.

e) Temat e kapitullit

- Nocioni bazë i manovrimit.
- Ruajtja e sigurisë së punëtorëve gjatë manovrimit.
- Stabilimentet e manovrimit.
- Personeli manovrues.
- Komunikimi gjatë manovrimit.
- Vëzhgimi i rrugëtimit gjatë manovrimit.
- Mjetet e punës dhe përdorimi.
- Kyçja e vagonëve.
- Ndarja – s'kapje e vagonëve.
- Llojet e lëvizjeve gjatë manovrimit.

f) Udhëzime didaktike për kapitullin

Rekomandohet që mësuesi të:

- bëjë ilustrim me foto, maket;
- bashkëbisedojë me nxënësit;
- bëjë ilustrim me foto, maket, skicime;
- organizojë ekskursion mësimesor.

g) Kushtet për realizimin e kapitullit

- foto, maket;
- skicime.

Kapitulli 8: Dispozitat për vagonët

5 orë

a) Qëllimet e kapitullit

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet të:

- shpjegojë kontrollimin e vagonëve;
- shpjegojë dispozitat e përgjithshme për ngarkimin e vagonëve ;
- shpjegojë dhe interpretoj ngarkurshmerin e vagonëve;

b) Temat e kapitullit

- Kontrollimi i vagonëve.
- Dispozitat e përgjithshme për ngarkimin e vagonëve.
- Ngarëkurshmeria e vagonëve të mallrave.

c) Udhëzime didaktike për kapitullin

Rekomandohet që mësuesi të:

- bëjë ilustrim me foto, maket;
- bashkëbisedojë me nxënësit,
- organizojë punë në grupe.

d) Kushtet për realizimin e kapitullit

- Fotografi, maketa.

Kapitulli 9: Përgatitja e trenave

8 orë

a) Qëllimet e kapitullit

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet të:

- citojë dispozitat e përgjithshme për përgatitje të trenave;
- shpjegojë mënyrën e radhitjes vagonëve në trena të udhëtarëve;
- shpjegojë mënyrën e radhitjes vagonëve në trena të mallrave;
- shpjegojë mënyrën e radhitjes vagonëve me materie të rrezikshme në trena;
- shpjegojë dhe interpretoj gjatësinë e trenave dhe numrin e boshteve –akësve.

b) Temat e kapitullit

- Dispozitat e përgjithshme për përgatitje të trenave.
- Radhitja-renditja e vagonëve në trena të udhëtarëve.
- Radhitja-renditja e vagonëve në trena të mallrave.
- Radhitja-renditja e vagonëve me materie të rrezikshme në trena të mallrave.
- Gjatësia e lejuar e trenave në metra dhe në akse.

c) Udhëzime didaktike për kapitullin

Rekomandohet që mësuesi të:

- bëjë ilustrim me foto, maket;
- bashkëbisedojë me nxënësit;
- organizojë ekskursion mësuesor.

d) Kushtet për realizimin e kapitullit

- skicat
- makete,
- foto.

Kapitulli 10: Dokumenti teknik dhe procesi teknologjik i stacionit

5 orë

a) Qëllimet e kapitullit

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet të:

- të shpjegojë dokumentin teknik pjesa e parë e stacionit
- të shpjegojë dhe interpretoj dokumentin teknik pjesa e II-të e stacionit
- të shpjegojë procesin teknologjik të punës në stacion

b) Temat e kapitullit

- Dokumenti teknik i stacionit pjesa e I-rë;
- Dokumenti teknik i stacionit pjesa e II-të
- Procesi teknologjik i stacionit.

c) Udhëzime didaktike për kapitullin

Rekomandohet që mësuesi të:

- të bëjë ilustrim me: foto, maket.
- të bashkëbisedojë me nxënësit,
- puna në grupe

d) Kushtet për realizimin e kapitullit

- Foto
- skica
- grafik i orarit të lëvizjes së trenave (OLT).

Programi i lëndës

“Organizimi transportit të mallrave”

<u>Lëmia:</u>	Transport
<u>Profili:</u>	Lëvizja e trenave
<u>Niveli:</u>	I
<u>Klasa:</u>	11

Qëllimet e lëndës

Në përfundim të trajtimit të lëndës në klasën e 11-të, nxënësi duhet të:

- shpjegojë rëndësinë e transportit të mallrave me hekurudhë;
- shpjegojë llojin e mallrave të cilat transportohen me hekurudhë;
- shpjegojë dhe plotësojë dokumentacionin përcjellës;
- shpjegojë dhe regjistrojë dërgesat-vagonët në regjistra në arritje dhe nisje;
- shpjegojë mënyrën e paketimit të mallrave;
- shpjegojë dhe lexoj fletëzimin e vagonëve;
- lexojë dhe të regjistrojë shënimet nga vagonët hekurudhor.

Fondi i orëve të lëndës

35 javë x 2 orë/javë = 70orë

Programi i hollësishëm i lëndës

Kapitulli 1: Hyrje në Organizimin e transportit të mallrave 3 orë

a) Qëllimet e kapitullit

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet:

- të shpjegojë dhe diskutojë mbi rëndësinë e transportit të mallrave
- të përshkruajë shkurt historikun e transportit të mallrave

b) Temat e kapitullit

- Rëndësia e transportit të mallrave me hekurudhë për një shoqëri
- Historiku i zhvillimit të transportit të mallrave me hekurudhë

c) Udhëzime didaktike për kapitullin

Rekomandohet që mësuesi të:

- bëjë ilustrim me foto, maket;
- bashkëbisedojë dhe diskutojë me nxënësit;
- organizojë punë në grupe.

d) Kushtet për realizimin e kapitullit

- Skica, foto.

Kapitulli 2: Pajisjet për manipulim me mallra 4 orë

a) Qëllimet e kapitullit

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet të:

- tregojë dhe identifikojë llojet e pajisjeve;

- shpjegojë veçoritë e tyre;
- shpjegojë mënyrën e manipulimit me pajisje;
- shpjegojë mënyrën e përcaktimit të vendeve zyrtare dhe vendeve të punës;
- japë shembuj të vendeve zyrtare nga Kosova dhe vende të tjera.

b) Temat e kapitullit

- Pajisjet hekurudhore për transport të mallrave.
- Llojet e stacioneve hekurudhore për transport të mallrave.
- Veçoritë e pajisjeve hekurudhore.
- Mënyra e manipulimit me pajisje.
- Vendet tjera zyrtare në hekurudhore.

c) Udhëzime didaktike për kapitullin

Rekomandohet që mësuesi të:

- bëjë ilustrim me foto, makete;
- bashkëbisedojë me nxënësit;
- organizojë ekskursion mësuesor;
- organizojë punë në grupe.

d) Kushtet për realizimin e kapitullit

- Makete dhe foto (nëse disponon).
- Skica të stacioneve.

Kapitulli 3: Dokumenti i transportit (fletëngarkesa) vendore

2 orë

a) Qëllimet e kapitullit

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet të:

- shpjegojë për dokumentin (fletëngarkesën);
- shpjegojë dhe plotësoj fletëngarkesën (K-501);
- shpjegojë dokumentet tjera për transport vendor.

b) Temat e kapitullit

- Fletëngarkesa vendore (K-501).
- Mënyra e plotësimit.
- Dokumentet tjera për transport (K- 316), (K-188), (Vag -35).

c) Udhëzime didaktike për kapitullin

Rekomandohet që mësuesi të:

- trajtojë shembuj konkretë;
- ilustrtojë me anë të skicimit dhe demonstrimit të dokumenteve përkatëse;
- bashkëbisedojë me nxënësit,
- organizojë punë në grupe.

d) Kushtet për realizimin e kapitullit

- Formularët të fletëngarkesës dhe dokumenteve të tjera përcjellëse.

Kapitulli 4: Dorëzimi i mallrave për transport

4 orë

a) Qëllimet e kapitullit

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet të:

- shpjegojë mënyrën e kërkimit të vagonëve adekuat për ngarkimin e mallrave;
- shpjegojë mënyrën e përzgjedhjes së vagonëve;
- shpjegojë mënyrën e sjelljes së mallrave dhe vendosjen e përkohshme deri në ngarkim;
- shpjegojë mënyrën e pranimit dhe kontrollimit të fletëngarkesës.

b) Temat e kapitullit

- Kërkesa e vagonëve për ngarkim.
- Përzgjedhja e vagonëve për ngarkim.
- Sjellja e mallrave dhe vendosja e përkohshme në depo ose vend të hapur.
- Pranimi i fletëngarkesës dhe kontrollimi- barazimi me mallin e planifikuar për ngarkim.

c) Udhëzime didaktike për kapitullin

Rekomandohet që mësuesi të:

- bëjë ilustrime sa më të shumta me shembuj, skica etj.
- bashkëbisedojë me nxënësit,
- organizojë punë në grupe.

d) Kushtet për realizimin e kapitullit

- Skica për mënyrën e ngarkimit të vagonëve.

Kapitulli 5: Dorëzimi i mallrave për transport

20 orë

a) Qëllimet e kapitullit

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet të:

- shpjegojë mënyrën e pranimit të mallrave;
- shpjegojë mënyrën e konstatimit përmbajtjes së mallit;
- shpjegojë mënyrën e ngarkimit në vagonë;
- shpjegojë mënyrën e përcaktimit të peshës (masës në peshoren e depos dhe të vagonëve);
- shpjegojë mënyrën e evidentimit të fletëngarkesës në librin e ekspeditimit (K-117);
- shpjegojë mënyrën e fletëzimit të vagonëve;
- shpjegojë mënyrën e mbylljes dhe plombimit të vagonëve.

b) Temat e kapitullit

- Pranimi i mallrave për transport.
- Konstatimi i përmbajtjes së mallit (ngarkesës).
- Ngarkimi i mallrave në vagonë.
- Përcaktimi i peshës (masës) së ngarkuar – dorëzuar për transport.
- Evidentimi i fletëngarkesës në librin e ekspeditimit (K-117).
- Fletëzimi i vagonëve.
- Plombimi i vagonëve.

c) Udhëzime didaktike për kapitullin

Rekomandohet që mësuesi të:

- ilustrojë çështjet që trajton me shembuj konkretë;
- bëjë ilustrim me foto, maket;
- bashkëbisedojë me nxënësit;
- organizojë punë në grupe.

d) Kushtet për realizimin e kapitullit

- Formularët .
- Foto, maketa.

Kapitulli 6: Transporti i mallrave

15 orë

a) Qëllimet e kapitullit

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet të:

- të shpjegojë mënyrën e dorëzimit të dërgesave dhe vagonëve në trena;
- të shpjegojë mënyrën ekspeditimit së mallrave me trena;
- të shpjegojë mënyrën përcjelljes së dërgesave;
- të shpjegojë mënyrën e lëshuerjes – dorëzimit të dërgesave dhe vagonëve në stacione (K-93);
- të shpjegojë mënyrën e ringarkimit të mallrave – dërgesave;
- të shpjegojë mënyrën e pranimit dhe dorëzimit të vagonëve në stacionet kufitare;
- të shpjegojë dhe plotësoj regjistrin e dorëzimit në stacionet kufitare (k-200)

b) Temat e kapitullit

- Dorëzimi i dërgesave dhe vagonëve në trena;
- Ekspeditimi i mallrave , vagonëve me trena;
- Përcjella e dërgesave –vagonëve në trena;
- Dorëzimi i vagonëve –dërgesave në stacione;
- Ringarkimi i mallrave;
- Pranim –dorëzimi i vagonëve në stacionet kufitare;
- Regjistri i dorëzimit në stacionet kufitare (K-200);

c) Udhëzime didaktike për kapitullin

Rekomandohet që mësuesi të:

- bëjë ilustrim me formularë;
- bashkëbisedojë me nxënësit;
- organizojë punë në grupe.

d) Kushtet për realizimin e kapitullit

- Foto, skica.
- Formularët përkatës.

Kapitulli 7: Dorëzimi i dërgesave –vagonëve

10 orë

Qëllimet e kapitullit

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet të:

- shpjegojë mënyrën e përgatitjes për dorëzim të dërgesave;
- shpjegojë elementet përbërës dhe plotësoj librin e Arritjes (K-254);
- shpjegojë mënyrën e lajmërimit të pranuesit për arritje të dërgesës – vagonit;
- shpjegojë mënyrën e shpagimit të fletëngarkesës;
- shpjegojë mënyrën e vërtetimit të numrit, peshës dhe llojit të dërgesës gjatë dorëzimit;
- shpjegon mënyrën e dorëzimit të dërgesave;
- shpjegojë mënyrën e rekspeditimit të dërgesave (ridorëzimi).

b) Temat e kapitullit

- Përgatitja për dorëzim të dërgesave.

- Libri i arritjes së dërgesave (K-254).
- Mënyrat e lajmit të pranuesit për arritje të dërgesës- vagonit.
- Shpagimi i fletëngarkesës.
- Vërtetimi i numrit, masës dhe llojit dhe gjendjes së dërgesës gjatë dorëzimit.
- Mënyra e dorëzimit të dërgesës-vagonit.
- Rekspeditimi (ridorëzimi) i dërgesave.

c) Udhëzime didaktike për kapitullin

Rekomandohet që mësuesi të:

- bëjë ilustrim me foto, formularë dhe skicime;
- demostrojë si plotësohen formularët;
- bashkëbisedojë me nxënësit;
- organizojë punë individuale duke dhënë detyra në klasë.

d) Kushtet për realizimin e kapitullit

- Foto, formularë dhe skicime.

Kapitulli 8: Transporti i kafshëve të gjalla

2 orë

a) Qëllimet e kapitullit

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet të:

- argumentojë nevojën për krijimin e kushteve të veçanta për transportin e kafshëve të gjalla;
- shpjegojë mënyrën e kërkesës, kontrollimit dhe vendosjes së vagonëve;
- diskutojë mbi mënyrën e ngarkimit të kafshëve të gjalla;
- përshkruajë kujdesin dhe mënyrën e përcjelljes së dërgesave me kafshë të gjalla;
- shpjegojë mënyrën e dorëzimit të pritësi.

b) Temat e kapitullit

- Transporti i kafshëve të gjalla- kushtet.
- Kërkesa e vagonëve, kontrollimi dhe vendosja për ngarkim.
- Mënyra e ngarkimit.
- Përcjella e dërgesave- vagonëve me kafshë të gjalla.
- Dorëzimi i dërgesave vagonëve me kafshë të gjalla.

c) Udhëzime didaktike për kapitullin

Rekomandohet që mësuesi të:

- të bashkëbisedojë dhe diskutojë me nxënësit;
- organizojë punë individuale dhe punë në grupe.

d) Kushtet për realizimin e kapitullit

- Fotografi, maketa.

Kapitulli 9: Transporti i dërgesave me materie të rrezikshme

5 orë

a) Qëllimet e kapitullit

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet të:

- përshkruajë veçoritë dhe identifikojë materiet e rrezikshme;
- përshkruajë dhe identifikojë dokumentacionin e nevojshëm për transport të materieve të rrezikshme;

- shpjegojë se ç'janë dhe t'i identifikojë fletëzimet e materieve të rrezikshme;
- shpjegojë domosdoshmërinë e marrjes së lejes nga organet kompetente për transport të materieve të rrezikshme;
- shpjegojë mënyrën e përcjelljes së dërgesave me materie të rrezikshme.

b) Temat e kapitullit

- Materiet e rrezikshme (RID).
- Dokumentacioni i nevojshëm për transport të materieve të rrezikshme.
- Fletat për fletëzimin e materieve të rrezikshme.
- Lejet nga organet kompetente për transport të materieve të rrezikshme.
- Mënyra e përcjelljes së dërgesave me materie të rrezikshme.

c) Udhëzime didaktike për kapitullin

Rekomandohet që mësuesi të:

- bëjë ilustrim me foto, maket;
- bashkëbisedojë me nxënësit;
- organizojë punë në grupe.

d) Kushtet për realizimin e kapitullit

- Skica, maketa, foto.

Kapitulli 10: Transportet ushtarake me hekurudhë

5 orë

a) Qëllimet e kapitullit

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet të:

- shpjegojë llojet e transporteve ushtarake;
- shpjegojë mënyrën e organizimit të transporteve ushtarake;
- shpjegojë mënyrën e instradimit të transporteve ushtarake;
- shpjegojë mënyrën e përcjelljes së transporteve ushtarake

b) Temat e kapitullit

- Transportet ushtarake – llojet.
- Organizimi i transporteve ushtarake.
- Instradimi i transporteve ushtarake.
- Përcjellja e transporteve Ushtarake.

c) Udhëzime didaktike për kapitullin

Rekomandohet që mësuesi të:

- bëjë ilustrim me foto, maket;
- bashkëbisedojë me nxënësit;
- organizojë punë në grupe.

d) Kushtet për realizimin e kapitullit

- Foto.
- Skica.

Programi i lëndës

“Organizimi i transportit të udhëtarëve”

<u>Lëmia:</u>	Transport
<u>Profili:</u>	Lëvizja e trenave
<u>Niveli:</u>	I
<u>Klasa:</u>	11

Qëllimet e lëndës

Në përfundim të trajtimit të lëndës në klasën e 11-të, nxënësi duhet të:

- shpjegojë rëndësinë e transportit të udhëtarëve me hekurudhë dhe historikun e këtij lloji transporti;
- citojë dispozitat e përgjithshme për transport të udhëtarëve;
- shpjegojë dhe dallojë llojet e biletave dhe mënyrën e dhënies së tyre në raste të ndryshme;
- llogarisë çmimin e biletës sipas kërkesës së udhëtarëve;
- shpjegojë kuptimin e beneficionit, kategoritë që përfitojnë beneficion dhe mënyrën e përfitimit të tij;
- përshkruajë veprimet për rezervimin e ulëseve-shtretërve;
- përshkruajë veprimet për shpagimin e shtesave;
- shpjegojë kuptimin e shënimeve të domosdoshme në bileta;
- përshkruajë veprimet që kryhen me valixhet e dorës;
- përshkruajë veprimet që kryhen për transportin e dërgesave ekspres.

Fondi i orëve të lëndës

35 javë x 2 orë/javë = 70 orë

Programi i hollësishëm i lëndës

Kapitulli 1: Hyrje në organizimin e transportit të udhëtarëve 2 orë

a) Qëllimet e kapitullit

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet të:

- shpjegojë rëndësinë e transportit të udhëtarëve për zhvillimin e një shoqërie;
- përshkruajë historikun e transportit të udhëtarëve me hekurudhë.

b) Temat e kapitullit

- Rëndësia e transportit të mallrave me hekurudhë për një shoqëri.
- Historiku i zhvillimit të transportit të udhëtarëve me hekurudhë.

c) Udhëzime didaktike për kapitullin

Rekomandohet që mësuesi të:

- bëjë ilustrim me foto, maket;
- bashkëbisedojë me nxënësit;
- organizojë punë në grupe.

d) Kushtet për realizimin e kapitullit

- skica, foto, harta.

Kapitulli 2: Dispozitat e posacme

5 orë

a) Qëllimet e kapitullit

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet të:

- shpjegojë elementet e kontratës për transport;
- shpjegojë mënyrën e sjelljes së udhëtarëve gjatë hyrjes në objekt të stacionit, në perone dhe në trena;
- shpjegojë mënyrën e dhënies së biletave;
- shpjegojë se ç'janë vendet zyrtare dhe vendet e tjera të punës në hekurudhë.

b) Temat e kapitullit

- Kontrata për transport të udhëtarëve.
- Hyrja në stacion, perona dhe në trena.
- Dhënia e biletave.
- Vendet e tjera zyrtare në hekurudhë.

c) Udhëzime didaktike për kapitullin

Rekomandohet që mësuesi të:

- bëjë ilustrim me: foto, maket;
- bashkëbisedojë me nxënësit;
- organizojë punë në grupe.

d) Kushtet për realizimin e kapitullit

- Skica të stacioneve, foto.

Kapitulli 3: Dokumenti i transportit –biletat

5 orë

a) Qëllimet e kapitullit

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet të:

- shpjegojë për dokumentin e transportit të udhëtarëve (biletën);
- shpjegojë llojet e shënimeve në bileta;
- shpjegojë afatet e vlerës së biletave

b) Temat e kapitullit

- Biletat e udhëtimit.
- Shënimet në bileta.
- Afatet e vlerës së biletave.

c) Udhëzime didaktike për kapitullin

Rekomandohet që mësuesi të:

- trajtojë shembuj konkretë;
- skicojë bileta;
- bashkëbisedojë me nxënësit;
- organizojë punë në grupe.

d) Kushtet për realizimin e kapitullit

- Mostrat e biletave
- Foto

Kapitulli 4: Llojet e biletave në komunikacionin vendor

12 orë

a) Qëllimet e kapitullit

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet të:

- përshkruajë elementet e biletës dhe shpjegojë se çfarë vërteton ajo;
- shpjegojë arsyet e përdorimit të biletave të llojeve të ndryshme;
- rendisë dhe identifikojë llojet e biletave;
- përshkruajë veçoritë e biletave të kartuçit;
- përshkruajë veçoritë e biletave mujore për nxënës (studentë) dhe punëtorë;
- përshkruajë veçoritë dhe identifikojë biletat fletë (K-8);
- përshkruajë veçoritë dhe identifikojë biletat K-2 dhe K-2a;
- përshkruajë veçoritë e biletës shtesë K-6 dhe K-6a.

b) Temat e kapitullit

- Llojet e biletave.
- Biletat e kartuçit (Biletat me shënime të shtypura).
- Biletat mujore.
- Biletat fletë K-8(Bileta me disa shënime të shtypura).
- Biletat fletë K-2 dhe K-2a. (Bileta të cilat shënimet plotësohen).
- Biletat shtesë K-6 dhe K-6a.

c) Udhëzime didaktike për kapitullin

Rekomandohet që mësuesi të:

- bëjë ilustrime me mostra biletash, foto etj.;
- bashkëbisedojë me nxënësit;
- organizojë punë në grupe.

d) Kushtet për realizimin e kapitullit

- Mostrat e biletave.
- Foto.

Kapitulli 5: Llogaritja e çmimit të biletës

6 orë

a) Qëllimet e kapitullit

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet të:

- shpjegojë mënyrën e përdorimit të tarifës;
- shpjegojë mënyrën e përdorimit të telemetrit;
- identifikojë dhe krahasojë çmimin e rëndomtë me çmimet me koncesione.

b) Temat e kapitullit

- Tarifa për transport të udhëtarëve.
- Telemetri i linjave hekurudhore.
- Çmimet e rëndomta dhe me koncesione (Beneficione).

c) Udhëzime didaktike për kapitullin

Rekomandohet që mësuesi të:

- ilustrojë çështjet që trajton me shembuj konkretë;
- bëjë ilustrim me: foto, maket;
- bashkëbisedojë me nxënësit;
- organizojë punë në grupe.

d) Kushtet për realizimin e kapitullit

- tarifa, telemetri.

Kapitulli 6: Llojet e beneficioneve në Hekurudhat e Kosovës

4 orë

a) Qëllimet e kapitullit

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet të:

- shpjegojë nocionin e beneficionit;
- shpjegojë rrugën e përfitimit të beneficioneve ligjore në transportin hekurudhor;
- shpjegojë rrugën e përfitimit të beneficioneve komerciale në transportin hekurudhor.

b) Temat e kapitullit

- Beneficionet në hekurudhat e Kosovës.
- Beneficionet ligjore.
- Beneficionet komerciale.

c) Udhëzime didaktike për kapitullin

Rekomandohet që mësuesi të:

- bashkëbisedojë me nxënësit;
- organizojë punë në grupe.

d) Kushtet për realizimin e kapitullit

- Foto- skica.
- formularë përkatës;
- rregullorja e transportit të udhëtarëve.

Kapitulli 7: Udhëtimet kolektive

6 orë

a) Qëllimet e kapitullit

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet të:

- shpjegojë veçoritë e udhëtimeve kolektive;
- shpjegojë mënyrën e ekspeditimit- përcjelljes;
- shpjegojë mënyrën e lajmërimit ekskursioneve dhe udhëtimeve kolektive;
- llogarisë çmimet e biletës për udhëtime kolektive.

b) Temat e kapitullit

- Udhëtimet kolektive.
- Mënyra e ekspeditimit.
- Mënyra e lajmërimit.
- Mënyra e llogaritjes së çmimeve për udhëtime kolektive- ekskursione shkollore.
- Formularët për udhëtime kolektive dhe ekskursione shkollore.

c) Udhëzime didaktike për kapitullin

Rekomandohet që mësuesi të:

- bëjë ilustrime të shumta me foto, formularë dhe mostra të biletave;
- demonstrojë si plotësohen formularët;
- bashkëbisedojë me nxënësit;
- organizojë orë ushtrimesh;
- organizojë punë në grupe.

d) Kushtet për realizimin e kapitullit

- foto, formularë dhe mostra të biletave.

Kapitulli 8: Beneficionet për pensioner dhe persona të moshuar

2 orë

a) Qëllimet e kapitullit

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet:

- shpjegojë beneficionet;
- shpjegojë mënyrën e dhënies së biletave.

b) Temat e kapitullit

- Beneficionet për pensioner dhe persona të moshuar.
- Dhënja e biletave pensioneve dhe personave të moshuar.

c) Udhëzime didaktike për kapitullin

Rekomandohet që mësuesi të:

- bashkëbisedojë me nxënësit;
- organizojë punë në grupe.

d) Kushtet për realizimin e kapitullit

- Mostra të biletave.

Kapitulli 9: Rezervimi i ulëseve- shtretërve

5 orë

a) Qëllimet e kapitullit

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet të:

- shpjegojë rëndësinë e rezervimit të ulëseve-shtretërve;
- shpjegojë dokumentacion –biletat për rezervimin e ulëseve-shtretërve;
- shpjegojë vendet zyrtare të cilat merren me rezervimin e ulëseve-shtretërve;
- shpjegojë shembujt e telegrameve për rezervimin e ulëseve-shtretërve.

b) Temat e kapitullit

- Rëndësia e rezervimit të ulëseve-shtretërve.
- Bileta- vërtetimi për ulësen-shtratin e rezervuar.
- Vendet zyrtare për rezervimin e ulëseve – shtretërve.
- Mënyra e lajmërimit të stacioneve për ulëset ose shtretërit e rezervuar.

c) Udhëzime didaktike për kapitullin

Rekomandohet që mësuesi të:

- bëjë ilustrim me foto, makete;
- bashkëbisedojë me nxënësit,
- organizojë punë në grupe.

d) Kushtet për realizimin e kapitullit

- skica, bileta, telegrame.

Kapitulli 10: Shpagimi i shtesave të cilat nuk kanë mundur të kryhen në tren 5 orë

a) Qëllimet e kapitullit

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet të:

- përshkruajë elementet përbërës dhe mënyrën e mbajtjes së proces verbalit (K-92);
- shpjegojë mënyrën e veprimit kur udhëtari nuk dëshiron të paguaj biletën;
- shpjegojë mënyrën e kthimit të çmimit të biletës së pa shfrytëzuar;
- shpjegojë mënyrën e vërtetimit të biletave të pa shfrytëzuara.

b) Temat e kapitullit

- Procesverbali K-92.
- Veprimet e ndërmarra kur udhëtari refuzon pagesën e biletës.
- Kthimi i çmimit të biletës të pa shfrytëzuar.
- Mënyra e vërtetimit të biletave të pa shfrytëzuar.

c) Udhëzime didaktike për kapitullin

Rekomandohet që mësuesi të:

- bëjë ilustrim me bileta;
- të bashkëbisedojë me nxënësit;
- organizojë punë në grupe.

d) Kushtet për realizimin e kapitullit

- mostra të biletave, skica.

Kapitulli 11: Valixhet e dorës

7 orë

a) Qëllimet e kapitullit

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet të:

- shpjegojë dhe identifikojë gjësendet si valixhe të dorës;
- shpjegojë dhe identifikojë gjësendet të cilat nuk pranohen për transport;
- shpjegojë paketimin dhe shënimet përkatëse;
- shpjegojë mënyrën e pranimit të valixheve të dorës;
- shpjegojë mënyrën e ekspeditimit dhe llogaritjes së shpenzimeve;
- shpjegojë mënyrën e ruajtjes dhe dhënies së valixheve.

b) Temat e kapitullit

- Gjësendet të cilat pranohen si valixhe të dorës.
- Gjësendet të cilat nuk pranohen si paligje të dorës.
- Paketimi dhe shënimet në gjësende.
- Pranimi i gjësendeve në transport dhe përcaktimi i masës-peshës.
- Ekspeditimi - dokumenti i ekspeditimit dhe llogaritja e shpenzimeve.
- Ruajtja dhe dhënia e valixheve të dorës.

c) Udhëzime didaktike për kapitullin

Rekomandohet që mësuesi të:

- bëjë ilustrime sa më të shumta;
- bashkëbisedojë me nxënësit;
- organizojë punë në grupe.

d) Kushtet për realizimin e kapitullit

- mostra, skica.

Kapitulli 12: Transporti i dërgesave ekspres në komunikacionin vendor 11 orë

a) Qëllimet e kapitullit

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet të:

- shpjegojë nocionin e dërgesave ekspres;
- përshkruajë procedurën e pranimit dhe dorëzimit të dërgesave ekspres për transport;
- shpjegojë elementet përbërës dhe plotësojë fletëngarkesën ekspres K-72;
- shpjegojë paketimin e shënjimin e dërgesave ekspres;
- shpjegojë mënyrën e ekspeditimit dhe llogaritjes së shpenzimeve të transportit
- shpjegojë mënyrën e informimit të pranuesit për arritje të dërgesës.

b) Temat e kapitullit

- Dërgesat ekspres- nocioni;
- Pranimi dhe dorëzimi i dërgesave ekspres për transport;
- Fletëngarkesa për dërgesat ekspres (K-72);
- Paketimi dhe shënimet në dërgesat ekspres;
- Llogaritja e shpenzimeve të transportit dhe ekspeditiv;
- Lajmërimi i pranuesit për arritje të dërgesës Ekspres.

c) Udhëzime didaktike për kapitullin

Rekomandohet që mësuesi:

- të bëjë ilustrim të shumta;
- të bashkëbisedojë me nxënësit;
- organizojë punë në grupe.

d) Kushtet për realizimin e kapitullit

- mostra, skica.

Programi i lëndës

“Hekurudha dhe pajisjet hekurudhore”

<u>Lëmia:</u>	Transport
<u>Profili:</u>	Lëvizja e trenave
<u>Niveli:</u>	I
<u>Klasa:</u>	11

Qëllimet e lëndës

Në përfundim të trajtimit të lëndës në klasën e 11-të, nxënësi duhet të:

- Shpjegojë nocionet e përgjithshme për hekurudhë;
- shpjegojë dhe dallojë, shtresën e ulët hekurudhore;
- shpjegojë dhe dalloj shtresën e lart hekurudhore;
- shpjegojë pajisjet hekurudhore;
- shpjegojë mënyrën e mirëmbajtjes së hekurudhës;
- shpjegojë për vendkalimet hekurudhore .

Fondi i orëve të lëndës

35 javë x 1 orë/javë = 35 orë

Programi i hollësishëm i lëndës

Kapitulli 1: Nocioni i përgjithshëm për hekurudhë

2 orë

a) Qëllimet e kapitullit

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet të:

- shpjegojë nocionet e përgjithshme për hekurudhë;
- përshkruajë zhvillimin e rrjetit hekurudhor.

b) Temat e kapitullit

- Nocionet e përgjithshme mbi Infrastrukturën hekurudhore.
- Zhvillimi i rrjetit hekurudhor në vend dhe në botë.

c) Udhëzime didaktike për kapitullin

